



Funded by
the European Union

RAPORT ANALITIK

Pritshmëritë e nxënësve
për arsim cilësor



EduPod 3



KEK

Gendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Projekti *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit* - shkurt **IDEA 2022**, financohet nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe vihet në zbatim nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit, projekti synon të identifikojë problematikat e fushës së arsimit në Kosovë duke zgjeruar hapësirat për debat publik me anë të shfrytëzimit të teknologjive inovative siç janë podcastet. Në këto diskutime janë të përfshira palë kyçe në sistemin arsimor, si nxënës/e, mësues/mësues/e, prindër, politikëbërës etj. ku u jepet mundësia për të ballafaquar mendimet dhe pikëpamjet e tyre.

Seria e podcasteve **EduPod** (shkurtesë e *Education Podcast*) është e para e llojit të vet në Kosovë, si podcasti i parë me karakter edukativo-arsimor i cili trajton çështjet e arsimit në këtë formë. Synohet që me anë të EduPod të shtrihet sa më gjerë debati rreth arsimit dhe të zgjerohen hapësirat për të dëgjuar dhe përfshirë mendimet e të gjitha palëve në arsim, me fokus të veçantë tek nxënësit/et. Këto raporte analitike janë përmbledhje e diskutimeve dhe rekomandimeve të dala nga podcastet e realizuara.

Design: **envinion**

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e programit një-vjeçar *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit* - **IDEA 2022**, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet (Framework Partnership Agreement) të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.



RAPORT ANALITIK

Pritshmëritë e nxënësve për arsim cilësor

Hyrje

Podkasti i parë me karakter specifik edukativo-arsimor në Kosovë, i quajtur **EduPod**, filloi realizimin e tij më 23 mars 2022 në kuadër të projektit *Zhvillimi Inovativ për Avancimin e Arsimit / Innovating Development for Education Advancement – IDEA 2022*, i cili financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës, KEC. Projekti IDEA 2022 synon përmirësimin e cilësisë së arsimit përmes identifikimit dhe trajtimit të çështjeve të arsimit në Kosovë me anë të debateve publike me bazë të gjerë.

Podkasti ‘Pritshmëritë e nxënësve për arsim cilësor’ është i treti prej një serie podkastesh të planifikuara gjatë këtij viti programor. Ky podkast është inicuar si rezultat i protestës së nxënësve të shkollave të mesme të larta, organizuar nga Këshilli i Nxënësve të Kosovës me moton ‘*S’po shkohet në shkollë*’.

Duke pasur parasysh se nxënësit/et janë përdoruesit/et parësorë/e dhe njëkohësisht përfundimtarë/e të produkteve të arsimit, dhe njëkohësisht janë pala që ka potencialin më të madh për të ofruar kontribut direkt lidhur me mënyrat e trajtimit të sfidave si dhe duke parë se janë të gatshëm ta ngritin zërin dhe të ofrohen për të kontribuar në tejkalimin e sfidave në këtë podkast janë ftuar të rinj të cilët janë përfaqësues të Këshillit të Nxënësve të Kosovës dhe Këshillit Rinor të Kosovës. Qëllimi i këtij podkasti ishte të dëgjojmë se cilat janë pritshmëritë e nxënësve për një arsim cilësor dhe idetë e tyre se si mund të arrihen. Shpesh herë e gjejmë veten në flluskën tonë të rehatshme dhe nuk dëshirojmë të dëgjojmë se çka mendojnë të tjerët. Por në fakt mu kjo është ajo që na nevojitet. Idetë e nxënësve mund të ndihmojnë shumë për një respekt të ndërsjellë dhe për ndërprerjen e lojës së hedhjes së fajit nga njëra palë te tjetra.

Mysafirët e këtij podkasti u zgjodhën duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në arsim, dhe konkretisht protestën ‘*S’po shkohet në shkollë*’, ku një numër i madh i nxënësve të shkollave të mesme të larta dolën në protestë, ku u përfaqësuan nga Denis Krasniqi, dhe publikimin e raportit ‘*Cilësia në Arsim: Perceptimi i nxënësve rreth përmbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor*’, të publikuar nga Kosovar Youth Council (KYC).



Pjesëmarrësit në diskutim ishin:

Denis Krasniqi, përfaqësues i Këshillit të Nxënësve të Kosovës, dhe

Ditjon Fetahu, Menaxher i Projekteve në Këshillin Rinor të Kosovës (KYC).

Përmbajtja e diskutimit në EduPod 3 u hartua në bashkëpunim të ngushtë mes ekspertës së angazhuar si konsulente për të realizuar këtë podkast dhe menaxheres së projektit IDEA 2022. Konsulentja ka hartuar një numër të pyetjeve për të dy mysafirët të cilat i ka diskutuar me menaxheren e projektit. Pyetjet ofronin mundësi për të diskutuar haptaz, duke iu shmangur përshkrimit të projekteve, renditjeve të gjetjeve nga raporti apo kërkesave të nxënësve, pra çështje që tashmë janë përmendur në emisione të tjera.



EduPod 3

është shfaqur me livestream nga faqja e Qendës për Arsim e Kosovës (KEC) në Facebook, dhe deri më 14 qershor 2022 ka arritur



560
shikime



ku shumë prej tyre kanë reaguuar dhe/ose komentuar dhe e kanë përcjellë ose shpërndarë më tej postimin.

Regjistrimi i podkastit në version audio dhe video është publikuar në kanalën e KEC-it në YouTube, dhe regjistrimi në version audio (mp3) është dërguar për transmetim në Radio Kosova.



Po ashtu, versioni audio i këtij podkasti është vendosur edhe në platformën elektronike të portalit Nacionalë. EduPod 3 mund të ndiqet në çdo kohë duke klikuar në vegzat e mëposhtme:



Faqja e KEC-it në Facebook:

<https://www.facebook.com/QendraperArsimeKosoves/videos/5478305605522283>



Kanali zyrtar i KEC-it në YouTube:

<https://www.youtube.com/watch?v=tQaZDvTK4jk&t=6s>



Në portalin Nacionalë:

<https://www.nacionale.com/Ballina/PodcastsDetails/157>

Rezultatet e identifikuara nga ky podkast i realizuar, ashtu si edhe podkasteve të tjera që zhvillohen në kuadër të projektit IDEA 2022, do të analizohen dhe trajtohen nga rrjeti informal i OSHC-ve të arsimit parauniversitar, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta nga përfaqësuesit e rrjetit dhe inicimit në nismave avokuese në fushën e arsimit.

Diskutimet

Diskutimi filloi me **Ditjon Fetahun**, i cili sqaroi arsyet e hartimit të raportit të KYC ‘*Cilësia në Arsim: Perceptimi i nxënësve rreth përmbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor*’. Ditjoni informoi dëgjuesit se KYC është organizata e cila e ka themeluar Këshillin e Nxënësve të Kosovës KNK në vitin 2005, përmes të cilit merren informata për çështjet që duhen shtyrë përpara dhe rekomandimet që duhet dhënë për përmirësimin e situatës së nxënësve në Kosovë. Raporti ‘*Cilësia në Arsim: Perceptimi i nxënësve rreth përmbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor*’ është edicioni i tretë i këtyre raporteve, ku i pari është publikuar në vitin 2010, i dyti në vitin 2016 dhe ky i treti në vitin 2022. Raporti i vitit 2022 dallon nga raportet e kaluara për faktin se përmban më shumë statistika, të cilat KYC i ka konsideruar të rëndësishme për të ngritur zërin dhe për të gjetur mënyra për përmirësimin e situatës në institucione edukativo-arsimore. Raporti mund të shkarkohet në <https://kyc-ks.org/wp-content/uploads/2022/04/Raporti-i-III-te-PRILL-2022.pdf>.

Ditjoni tregoi se gjetjet e këtij raporti janë pothuaj se të njëjta me dy raportet tjera, që nënkupton se për më shumë se dy dekada situata në shkolla nuk ka ndryshuar, edhe pse pritshmëritë e KYC kanë qenë që së paku në aspekt të mjedisit mësimor situata të jetë më e mirë pasi që ka pasur investime në këtë aspekt. Por është vërejtur se ka vazhduar të ndodhë ajo që është tashmë e njohur ku pajisjet, librat e mjetet e tjera mbahen të mbyllura dhe nuk përdoren fare.

Duket se fakti që ky raport është më i fokusuar në aspektin sasior dhe të dhënat janë mjaft shqetësuese ka aritur të bëjë bujë më shumë se raportet tjera të cilat kanë qenë cilësore për nga natyra. Ai tregoi se Komuna e Fushë-Kosovës tanimë e ka marrë për bazë raportin e KYC dhe po bën një hulumtim të ngjashëm me shkollat filllore dhe të mesme të ulëta në nivel komune. KYC së shpejti do të dalë me raportet e fokusuar në nivel komune të bëra nga grupi i monitoruesve të rinj dhe KNK.

Duke marrë për bazë raportin dhe gjetjet e tij, por duke i lënë anash çështjet që kanë të bëjnë me infrastrukturën, funksionalizimin e bibliotekave dhe sigurimin e psikologëve në shkolla, diskutimi vazhdoi me **Denis Krasniqin** sa i përket mësimdhënies dhe raportit mësimdhënës-nxënës. Raporti ka dalë me të dhëna se gjysma e nxënësve konsiderojnë se mësimdhënia është e mërzhitshme, dhe gjysma e nxënësve konsiderojnë se bullizohen nga mësimdhënësit. Denisi tregoi se çka do ta bënte shkollën më atraktive për nxënësit sa i përket mjedisit, pasi që shkolla përjetohet si burg, jo vetëm në aspektin psikologjik por edhe në atë fizik.

Sipas Denisit, janë dy fronte në të cilat duhet të punohet në shkolla. E para shkollat duhet të kenë laboratorë, kompjuterë dhe libra të mjaftueshëm për ta bërë mësimin më atraktiv dhe cilësor dhe e dyta që të ulet numri i viteve në të cilat mësimdhënësit punojnë me nxënës. Sipas tij mësimdhënësit me përvojë të gjatë mund të kontribuojnë shumë si mentorë, këshilldhënës dhe hartues të kurrikulave, mjeteve mësimore dhe politikave të arsimit por në raport me nxënës janë të harxhuar. Pavarësisht se kjo ide është shumë e mirë, ajo kërkon planifikim shumë të madh dhe buxhet të konsiderueshëm për shkak të numrit të madh të mësimdhënësve.

Gjithashtu, fakti se mësimdhënësit e rinj janë më të përshtatshëm për mësimdhënie nuk është detyrimisht i saktë, por vlen të punohet në drejtim të jetëgjatësisë së punës direkte me nxënës, pasi që puna me nxënës vërtet të harxhon, e sidomos në këtë kohë të ndryshimeve të mëdha që sjell teknologjia.

Ndërsa, sa i përket raportit mësimdhënës-nxënës, Denisi konsideron se rregullimi i çështjes së mjeteve didaktike dhe moshës së mësimdhënësve kjo do të ndikojë edhe në uljen e bullizmit nga mësimdhënësit, edhe për faktin se mësimdhënësit më në moshë ka disa sjellje të caktuara që nuk i konsiderojnë si ngacmim apo bullizim.

Duke marrë për bazë faktin se të drejtat shkojnë bashkë me përgjegjësi dhe pritshmëritë shkojnë bashkë me kontribut, Denisi diskutoi për mënyrën se si nxënësit mund të kontribuojnë për një mësim më cilësor. Gjatë protestës nxënësit patën edhe një kërkesë, e që ishte ‘Me neve, për neve’. Me këtë ata po kërkojnë që t’u mundësohet, por edhe po ofrohen, që të përfshihen në grupe punuese dhe ta ofrojnë kontributin e tyre në rastet kur merren vendimet për ta.

Ditjoni vazhdoi me diskutimin se si mund të fuqizohen këshillat e nxënësve në tërë Kosovën në mënyrë që të kontribuojnë për një arsim më cilësor. Njohja e të drejtave të nxënësve dhe organizimi e funksionalizimi i Këshillave të Nxënësve është mënyra se si mund të arrihet kjo gjë. KYC punon vazhdimisht në këtë drejtim dhe para dy viteve ka arritur ta implementojë Udhëzimin Administrativ i cili përcakton mënyrën e zgjedhjes dhe funksionimit të Këshillit të Nxënësve në nivel shkolle, komune dhe vendi. Kjo ka ndihmuar sado pak në depolitizimin e Këshillave të Nxënësve e që rrjedhimisht ka ndikuar në depolitizimin dhe mos-kontrollimin e Këshillave Drejtues të Shkollave. Ai e përmendi edhe çështjen e mos-zgjedhjes së Këshillit të Nxënësve brenda afatit prej 3 muajsh, ku kompetencat i kalojnë drejtorit të shkollës; sipas raporteve të KYC, kjo ka ndodhur në shumë raste dhe kjo e pengon dëgjimin e zërit të nxënësve për çështje të cilat kanë të bëjnë me ta.

Sidoqoftë, e gjithë kjo bëhet me mbështetje të projekteve dhe donatorëve, çka do të thotë se mungon mbështetja sistematike nga ana e institucioneve qeveritare dhe lokale për Këshillin e Nxënësve, qoftë me hapësira apo me burimet e nevojshme. Sipas Ditjonit, kjo është një çështje mjaft me rëndësi për fuqizimin e Këshillave të Nxënësve të cilët rrjedhimisht mund të kontribuojnë për një arsim më cilësor.

Në vazhdim u diskutua për shëndetin mendor të nxënësve, sa kuptohen dhe përkrahen nga mësimdhënësit.

Sipas Denisit, shëndeti mendor duhet të jetë lëndë e posaçme dhe përfshirë në shkollë, përmes së cilës nxënësit do të mësonin më thellë dhe do të ishin më të hapur për të kërkuar ndihmën e psikologut. Gjithashtu ai theksoi se shkollat duhet të kenë psikologë të cilët mund të ndihmojnë që ta ruajnë shëndetin mendor të nxënësve në të cilin ndikojnë shumë mediat sociale. Ditjoni u pajtua që duhet të ketë lëndë për shëndetin mendor si dhe psikologë në shkolla por, për dallim nga Denisi, ai mendon se ky nuk është vetëm problem i nxënësve por edhe mësimdhënësit duhet të jenë të gatshëm të ndihmojnë, e njëkohësisht edhe Këshilli i Nxënësve të shkollës duhet të ndihmojë duke i referuar rastet.

Diskutimi u përmyll me përshkrimin e Denisit për një ditë 'Kur shkohet në shkollë.' Sipas tij, çdo gjë duhet të fillojë me një mikpritje sapo të hysh në shkollë, e jo me britma nga personeli i shkollës, qoftë mësuesi apo teknik. Në këtë ndikon shumë edhe ambienti shkollor, ku ndoshta do të ndihmonte edhe lejimi i një hapësire për të shkruar nxënësit, si dhe klasat të jenë më të këndshme për sy. Mësuesit duhet të jenë të disponuar për orë mësimore e jo t'i sjellin të gjitha problemet e veta në orë, si dhe të mos kenë qasje shumë autoritative sepse kjo ndikon në mosrespektimin dhe moskomunikimin nga nxënësit. Nxënësit kanë nevojë të ndihen të respektuar.

Për çështjen e respektit edhe Ditjoni u pajtua, dhe theksoi se respekti duhet të jetë i ndërsjellë. Për këtë ka nevojë për monitorim të mirëfilltë, pasi që monitorimi që po bëhet për momentin nuk është aspak efikas. Në lidhje me respektin, janë mësuesit ata që e kanë për detyrë të ndikojnë për ta rregulluar pikësëpari, sepse ata janë profesionistët e thirrur për të ndikuar në atmosferën dhe vëmendjen në klasë.

Dallimi në mes të gjeneratave u theksua disa herë nga të dy mysafirët si një nga problemet për moskuptim dhe krijim të sfidave në mes të mësuesve dhe nxënësve.

Përfundime

Pjesëmarrësit në EduPod 3 diskutuan dhe sollën mjaft ide dhe rekomandime të cilat do të ndikonin në një mësim më cilësor.

Disa nga idetë dhe rekomandimet e dhëna gjatë EduPod 3:

- Të merren parasysh dhe t'u jepet rëndësia e duhur gjetjeve të raportit 'Cilësia në Arsim: Perceptimi i nxënësve rreth përmbajtjes, procesit dhe mjedisit mësimor' të KYC në bashkëpunim me KNK;
- Mjedisi shkollor të jetë më i këndshëm për nxënësit, ku vetë nxënësit mund të kontribuojnë në krijimin e tij;
- Shkollat, në bashkëpunim me DKA-të dhe MASHTI-n, të angazhohen për sigurimin e kabineteve, kompjuterëve dhe librave;
- Të zvogëlohet numri i viteve të punës direkte me nxënësit, dhe të kombinohet me punë këshilluese, monitoruese dhe mentoruese në instanca të ndryshme;
- Nxënësit të ftohen në grupe punuese ku merren vendime për ta;
- Të zbatohet Udhëzimi Administrativ për Këshillat e Nxënësve, dhe të dëgjohet zëri i tyre;
- Të përkrahen Këshillat e Nxënësve nga shkolla dhe personeli i saj, qoftë me hapësirë brenda shkollës, qoftë me lejim të shfrytëzimit të hapësirës edhe pas përfundimit të mësimit, që do të ndikonte në përjetimin e shkollës si të veten;
- Të sigurohen psikologë për shkolla si diçka e domosdoshme në këtë kohë të zhvillimit të madh të teknologjisë dhe bullizmit kibernetik;
- Të ketë lëndë për shëndetin mendor.



Funded by
the European Union

